



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr.500/2022
Datë: 27 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 14 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, nenit 12 të Rregullores nr. 02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e 301-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Z. Mentor Bajraktari, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë, caktohet nënkryetar i Gjykatës Themelore Prishtinë.
- II. Mandati i z. Bajraktari, si nënkryetar i gjykatës është i njëjtë me mandatin e kryetarit të gjykatës, siç përcaktohet me nenin 14 paragrafi 3 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nga kryetarja e Gjykatës Themelore Prishtinë znj. Albina Shabani Rama, ka pranuar propozim për caktimin e z. Mentor Bajraktari, nënkryetar të gjykatës.

KGJK, në takimin e mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, në konsultim me kryetaren Shabani-Rama, caktoi gjyqtarin Mentor Bajraktari, nënkryetar të Gjykatës Themelore Prishtinë, i cila do të ndihmojë në menaxhimin e gjykatës dhe në mungesë të kryetares shërben si ushtrues detyre i kryetarit të gjykatës, me mandatin e paraparë sipas nenit 14 paragrafi 3 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat.

Andaj, nga se u tha si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Znj. Albina Shabani Rama, kryetare e Gjykatës Themelore Prishtinë;
- Z. Mentor Bajraktari, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.